



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

Rregullore për funksionimin e brendshëm të Bordit të Akreditimit

Miratuar me Vendimin Nr. 224, datë 15.12.2023



Neni 1: Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat e Bordit të Akreditimit të ASCAL-it. Rrjedhimisht, ajo përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Akreditimit, organizimin e tij të brendshëm, thirrjen e mbledhjeve dhe procedurat e vendimmarrjes, konfliktet e mundshme të interesit dhe konfidencialitetin.

Neni 2: Baza ligjore

Kjo Rregullore miratohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*; Ligjin Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*; Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dheenteve publike”*, i ndryshuar; Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar; Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*; Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në arsimin e lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”*, i ndryshuar.

Neni 3: Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat dhe akronimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- ASCAL– Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
- Kodi i cilësisë së Arsimit të Lartë - përmbledhje e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Neni 4: Misioni

Bordi i Akreditimit është një organ kombëtar kolegjial, që siguron cilësinë e jashtme të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, nëpërmjet vendimeve për akreditimin dhe monitorimin e ruajtjes së standardeve të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5: Përbërja e Bordit

- 5.1 Bordi i Akreditimit përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 3 deri në 5 prej tyre janë anëtarë të huaj. Anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të kenë të paktën një përvojë 10-vjeçare në institucione akademike dhe kërkimore, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit. Ata duhet të kenë gradë shkencore, titull akademik, ose të kenë të paktën pesë vite përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të zotërojnë gjuhën angleze, si në të folur ashtu edhe në të shkruar.
- 5.2 Bordi i Akreditimit mbështetet në kryerjen e veprimtarisë së tij nga Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin pranë ASCAL.
- 5.3 Në Bordin e Akreditimit merr pjesë edhe një student, në rolin e vëzhguesit, përfaqësues i

Këshillit Kombëtar të Studenteve.

- 5.4 Emërimi dhe lirimi nga detyra i Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Akreditimit, kryhet me Urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit përgjegjës për arsimin. Anëtarët e Bordit të Akreditimit caktohen për një mandat 4-vjeçar.

Neni 6: Detyrat dhe përgjegjësitë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Akreditimit, janë si më poshtë:

- 6.1 **Merr vendimin përfundimtar për akreditimin e një programi dhe/ose institucioni të caktuar.** Vendimi për akreditimin mund të jetë **pozitiv ose negativ.** Kur vendimi është **pozitiv** vlefshmëria e akreditimit institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet.
- 6.2 Argumenton dhe mbështet vendimet e tij për akreditimin, duke marrë parasysh **të dhënat dhe evidencat** e mëposhtme: kontekstin ligjor të institucionit, të dhënat kryesore për institucionin dhe programet e tij, raportet e vetëvlerësimit dhe evidencat mbështetëse, raportin e vlerësimit nga grupi i vlerësimit të jashtëm, raportimin verbal eventual nga ana e anëtarëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në mbledhjen e Bordit të Akreditimit, të dhënat për procedurat e vlerësimit, rezultatet dhe përfundimet nga vlerësime/akreditime të mëparshme, informacionin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimeve/akreditimeve të mëparshme dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme.
- 6.3 **Vendos për kohëzgjatjen dhe afatin e vlefshmërisë së akreditimit,** në rast se ka marrë njëvendim pozitiv.

Kriteret për përcaktimin e vlefshmërisë së akreditimit institucional ose të programeve të studimit janë:

- a. Niveli i plotësisë të standardeve të kodit të cilësisë sipas rezultateve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- b. Rezultatet e akreditimeve të mëparshme dhe plotësimin e rekomandimeve në vijim si dhe në ecurinë e cilësisë nga njëri akreditim në tjetrin;
- c. Rezultatet e monitorimit dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë nga licensimi/hapja e Institucionit të arsimit të lartë dhe/ose programit të studimit e në vijim;
- d. Qëndrueshmërinë institucionale në lidhje me të dhënat, dokumentacionin dhe proceset që lidhen e janë në funksion të ruajtjes dhe rritjes së standardeve të cilësisë së ofertës akademike;
- e. Për programet e studimit, kohëzgjatja e vlefshmërisë dhe afatit të akreditimit, përcaktohet në raport edhe me kohëzgjatjen e programit të studimit.

Kohëzgjatja e akreditimit përcaktohet në vite akademike. Data e përfundimit shprehet në formatin: ditë/muaj/vit.

- 6.4 Zbaton Kodin e Procedurave Administrative për marrjen e vendimeve. Vendimi i Bordit të Akreditimit konsiderohet si përfundimtar.

- 6.5 **Shqyrton ankesat** lidhur me procesin e vendimmarrjes për sigurimin e cilësisë dhe merr **vendimin** për ta pranuar apo për ta refuzuar ankesën, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Ankesa duhet të bëhet kundrejt një procedure të caktuar, që është në kompetencë të Bordit të

Akreditimit. Ankesa duhet të bazohet në argumente dhe shoqërohet me evidenca mbështetëse.

- 6.5.1 Bordi i Akreditimit ngre një komision të posaçëm, të përbërë nga tre anëtarë (dy anëtarëtë Bordit të Akreditimit, me të paktën një anëtar të huaj, dhe një përfaqësues të ASCAL-it).
- 6.5.2 Komisioni i posaçëm shqyrton ankesën dhe nëse e gjykon të arsyeshme mund të kërkojë thirrjen e një mbledhjeje me palë të ndryshme të përfshira në këtë proces, për të dhënë shpjegime dhe argumente.
- 6.5.3 Komisioni i posaçëm harton një raport me konstatimet dhe përfundimet e tij, të mbështetura në evidenca, dhe ia dorëzon Bordit të Akreditimit.
- 6.5.4 Bordi i Akreditimit vendos në lidhje me ankesën, duke u bazuar në raportin e komisionit të posaçëm dhe shpjegimet që shoqërojnë vendimin e këtij të fundit.
- 6.5.5 Kundër vendimeve të Bordit të Akreditimit mund të ushtrohet ankimim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi.
- 6.6 **Vendos, mbi bazën e kërkesës, evidencave dhe dokumentacionit të një institucioni të arsimit të lartë, miratimin për vlerësimin e jashtëm nga një agjenci e huaj e sigurimit të cilësisë.**
- 6.7 **Shqyrton raportet e vlerësimit, me kërkesë të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për vlerësimin paraprak, në rast të themelimit dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimeve, dhe i rekomandon Ministrisë përgjegjëse për arsimin themelimin dhe/ose riorganizimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.**
- 6.8 **Lëshon Certifikatën zyrtare të Akreditimit** brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit pozitiv për akreditimin. Certifikatat tip miratohen nga Bordi i Akreditimit dhe përmbajnë një kod unik të identifikimit që i referohet regjistrit të certifikimit. Certifikata bashkë nënshkruhet nga Kryetari i Bordit të Akreditimit dhe Drejtori i ASCAL-it. Vendimi dhe certifikata i dërgohet Titullarit të institucionit përkatës të arsimit të lartë, ose çdo personi tjetër të autorizuar, dhe bëhen publike në faqen zyrtare.
- 6.9 I kërkon ASCAL-it të **monitorojë performancën** e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, bazuar në rezultatet e procesit të akreditimit.
- 6.10 **Rivlerëson dhe rishqyrton vendimet e tij të akreditimit**, në rastet kur:
 - 6.11.1 ASCAL-i identifikon mungesë përputhshmërie me standardet, ose devijime të mundshme prej tyre, pas marrjes së akreditimit fillestar ose gjatë periudhës së akreditimit.
 - 6.11.2 Ai (Bordi i Akreditimit) ka dyshime të arsyeshme për uljen në cilësi, devijim nga standardet e cilësisë ose nga parashikimet ligjore.
 - 6.11.3 Ministria përgjegjëse për arsimin, i dërgon të dhëna dhe dokumente për shkelje të mundshme të standardeve të cilësisë ose parashikimeve ligjore.

Bordi i Akreditimit ngre një komision të posaçëm për të shqyrtuar rastet e identifikuara, në bashkëpunim me përfaqësues të ASCAL-it dhe të Bordit të Akreditimit, dhe nëse është e nevojshme, bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm. Komisioni shqyrton informacionin qëka në dispozicion dhe mund të kërkojë evidenca shtesë ose caktimin e mbledhjeve të tjera me palë të ndryshme. Komisioni harton një raport, të cilin ia dërgon Bordit të Akreditimit për vendimmarrje të mëtejshme.

Në rast se Bordi i Akreditimit identifikon shkelje ligjore ose devijime të tjera nga parashikimet ligjore, ai njofton Ministrinë përgjegjëse për arsimin për inspektime të mëtejshme. Ky parashikim është i zbatueshëm edhe për ato institucione të arsimit të lartë që i janë nënshtruar procesit të akreditimit.

6.11 Merr parasysh akreditimin e institucioneve të huaja në vendin e tyre të origjinës, për të marrë një vendim lidhur me akreditimin e **programeve të përbashkëta të studimit**, të ofruara nga institucione shqiptare dhe të huaja të arsimit të lartë, si edhe filiatet përkatëse të institucioneve të arsimit të lartë që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Rrjedhimisht, ASCAL-i verifikon statusin zyrtar të akreditimit të institucionit(eve) partner(e). Bordi i Akreditimit mund të kërkojë informacion shtesë për institucionet e përfshira të arsimit të lartë.

6.12 **Miraton raportin vjetor** për performancën e tij dhe të ASCAL-it, i cili bëhet publik brenda tre-mujorit të parë të vitit të mëposhëm kalendarik. Raporti përmban të paktën krerët e mëposhtëm:

- Parathënie (nga Kryetari i Bordit të Akreditimit dhe Drejtori i ASCAL-it);
- Zhvillimet më të fundit në sistemin shqiptar të arsimit të lartë;
- Veprimtari, procedura dhe projekte:
 - procedura dhe vendime për akreditimin, sondazhi kombëtar i studentëve;
 - raporte dhe analiza për gjetjet e përgjithshme nga procedurat e sigurimit të cilësisë(ESG 3.4);
 - pjesëmarrje në projekte dhe rrjete ndërkombëtare;
 - bashkëpunim me palë interesi (Ministrinë përgjegjëse për arsimin, institucione të arsimit të lartë, shoqata e studentëve, sektori i ekonomisë, ...);
 - veprimtari informuese dhe komunikimi: konferenca, ëorkshop-e, evente;
 - burime njerëzore dhe financiare (ESG 3.5);
 - menaxhimi i brendshëm i cilësisë dhe zhvillimi organizativ, zhvillimi i stafit (ESG 3.6).

6.13 **Miraton deklaratën e misionit** të ASCAL-it dhe çdo rishikim të saj.

6.14 **Miraton kriteret e posaçme për përzgjedhjen e ekspertëve** vendas dhe të huaj, për vlerësimin institucional dhe të programeve të studimit. Kriteret iu nënshtrohen procesit të vlerësimit në baza vjetore. Kriteret mund të rishikohen dhe/ose modifikohen në çdo moment, nga ana e Bordit të Akreditimit.

6.15 **Miraton në baza vjetore listën e ekspertëve** vendas dhe të huaj, që do të angazhohen në komisionet e vlerësimit, në vijim të propozimeve të ASCAL-it dhe organeve ndërkombëtare (p.sh. ENQA, EUA, ESU,...).Lista e ekspertëve është objekt i përditësimeve të vazhdueshme në mbledhjet e Bordit të Akreditimit.

6.16 **Miraton rregulloren e brendshme për funksionimin dhe veprimtarinë e ASCAL-it me kërkesë të ASCAL.**

6.17 **Miraton metodologjinë dhe instrumentet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve** për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, me propozim të ASCAL-it.

6.18 **Shqyrton, para publikimit, raportet përfundimtare për Sondazhin Kombëtar të Studentëve** dhe më pas e miraton atë.

Neni 7: Konflikti i interesit

- 7.1 Konflikti i interesit ekziston kur një anëtar i Bordit të Akreditimit ka **marrëdhënie të ngushtë me një institucion të arsimit të lartë dhe/ose programet e tij të studimit**, që janë objekt i vendimmarrjes së Bordit të Akreditimit. Marrëdhëniet e ngushta përfshijnë:
- punësimin aktual ose shërbime të tjera ndaj institucionit të arsimit të lartë;
 - pjesëmarrjen në ndonjë bord apo komitet të institucionit të arsimit të lartë;
 - punësimin e mëparshëm ose shërbime të tjera (në 5 vitet e fundit);
 - punësimin aktual ose ndonjë përfshirje nga ana e pjesëtarëve të familjes së tij/saj;
 - bashkëpunimin aktual në projekte;
 - bashkëpunimin e mëparshëm në projekte kërkimore (në 3 vitet e fundit).

Anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të **deklarojnë** paraprakisht në rast se ndodhen në konflikt interesi.

- 7.2 Në rast konflikti interesi, anëtari i Bordit të Akreditimit nuk përfshihet gjatë procesit të adresimit të rastit në fjalë. Anëtarit **nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni apo raportet** për procedurën specifike. Ai/ajo **largohet nga salla e mbledhjes gjatë diskutimeve dhe gjatë votimeve për marrjen e vendimeve** që i përkasin institucionit në fjalë.

Neni 8: Mbledhjet

- 8.1 Bordi i Akreditimit mbledhet **12 herë në vit**. Nëse është e nevojshme, Bordi mund të mbledhet deri në 3 (tri) here të tjera, brenda të njëjtit vit kalendarik, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin.
- 8.2 Mbledhja e Bordit të Akreditimit kryhet në prani të **të paktën tetë anëtarëve**.
- 8.3 **Datat e mbledhjeve** dakordësohen disa muaj para.
- 8.4 **Mungesa e një anëtari** duhet të **miratohet nga Kryetari**. Anëtari e njofton Kryetarin të **paktën 48 orë para dhe e arsyeton mungesën e tij/saj**. Çdo mungesë në mbledhje arsyetohet dhe dokumentohet në procesverbalin e mbledhjes. Në rast shkeljeje të këtyre rregullave dhe mungesës në më shumë se një e treta e mbledhjeve gjatë një periudhe 12 mujore, Bordi i Akreditimit i kërkon Këshillit të Ministrave zëvendësimin e anëtarit në fjalë.
- 8.5 Sektorit të Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimit pranë ASCAL, i dërgohet një **projekt-agjendë** të paktën 14 ditë para mbledhjes. Çdo anëtar i Bordit të Akreditimit mund të kërkojë **shtimin e pikave në agjendë deri në 7 ditë para** mbledhjes.
- 8.6 **Agjenda miratohet** në fillim të mbledhjes. **Gjatë mbledhjes**, është i mundur **zgjerimi i agjendës** me anë të votimit. Çdo vendim për akreditimin nuk mund t'i shtohet agjendës, nëse procedurat përkatëse nuk kanë qenë pjesë e agjendës provizore.
- 8.7 Mund të kërkohet thirrja e **mbledhjeve shitesë** nga të paktën gjashtë anëtarë, shoqëruar me një agjendë të propozuar, e cila duhet të planifikohet të paktën 6 javë para.
- 8.8 ASCAL-i dërgon **dokumentet e mbledhjes** të paktën 10 ditë pune para mbledhjes. Në raste të veçanta, kur ka çështje urgjente për të cilat nevojitet vendimmarrje, ASCAL mund të dërgoj dokumentacion deri në 48 orë para mbledhjes.
- 8.9 Mund të thirret një **mbledhje e jashtëzakonshme**, me kërkesë të Kryetarit ose të gjashtë anëtarëve të Bordit të Akreditimit, së bashku me një agjendë të propozuar, e cila duhet të planifikohet të paktën 2 ditë para.

- 8.10 **Kryetari i Bordit të Akreditimit kryeson mbledhjen. Në rast mungese, Zëvendës Kryetari i Bordit të Akreditimit e kryeson atë. Në rast mungese të të dyve, anëtari më i vjetër kryeson mbledhjen.**
- 8.11 **Kryetari e hap mbledhjen, iu jep anëtarëve fjalën gjatë diskutimeve, iu kërkon të votojnë dhe shpall vendimet.**
- 8.12 Kryetari mund të vendos për **zhvillimin e mbledhjeve** nëpërmjet teknologjisë dixhitale, në rast pamundësie për të qenë i pranishëm dhe kur nuk është plotësuar kuorumi prej tetë anëtarësh. Përgatitjet teknike duhet të bëhen para mbledhjes.
- 8.13 Mbledhjet nuk janë **të hapura për publikun** dhe temat e diskutimit trajtohen me **konfidencialitet**. Mendimet dhe votat e anëtarëve të veçantë nuk iu zbulohen palëve të treta apo publikut.
- 8.14 **Drejtori i ASCAL-it merr pjesë** në mbledhje, por pa të drejtë vote. Edhe anëtarë të tjerë të stafit mund t'i ndjekin mbledhjet e Bordit, sipas kërkesës.
- 8.15 Anëtarëve të jashtëm (p.sh. ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë, ekspertëve të tjerë) mund t'ju bëhet ftesë për të ofruar informacion dhe prova lidhur me tema specifike të agjendës. Informacioni mbahet i fshehtë.
- 8.16 Pas çdo takimi mbahen **procesverbalet e mbledhjes** nga ASCAL-i. Procesverbalet përmbajnë agjendën e mbledhjes, paraqitjen dhe mungesat e anëtarëve, dhe **rezultatet dhe vendimet kryesore (duke përfshirë numrin e votave)**. Përmbajtja e raporteve të vlerësimit dhe ediskutimeve merret në konsideratë deri në masën që është e nevojshme për të kuptuar zgjidhjet e dhëna. **Projekt-procesverbalet** iu dërgohen anëtarëve, së bashku me ftesën për mbledhjen e radhës, para mbledhjes në fjalë. Me dërgimin e tyre, mund të lihet edhe një afat për dorëzimin e komenteve me shkrim. Procesverbalet **miratohen në mbledhjen e ardhshme**. Procesverbalet e miratuara nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Bordit të Akreditimit.

Neni 9: Vendimet

- 9.1 Çdo anëtar ka të drejtën e **një vote të vetme**. E drejta për të votuar **nuk mund t'i transferohet** një anëtar tjetër.
- 9.2 **Vendimet janë të vlefshme kur** merren me shumicë prej $\frac{3}{4}$ të **anëtarëve të pranishëm. Kryetari voton i fundit.**
- 9.3 Në rast të **mosplotësisimit të kuorumit** të nevojshëm, votimi **shtyhet për** në mbledhjen e radhës.
- 9.4 **Votimi në distancë** mund të kryet për **çështje që nuk kanë nevojë për diskutim** dhe për të cilat duhet të merret **një vendim para mbledhjes së ardhshme**. Kërkesat për vendime dorëzohen me shkrim dhe përmbajnë arsyetimin përkatës. Çështja duhet të shtjellohet në atë mënyrë që të mbështesë një vendim pozitiv ose negativ. Vendimi merret nëse **të paktën tetë anëtarë i kanë dërguar votat e tyre**. Në rast se një anëtar **kërkon organizimin e diskutimit për atë temë**, ajo të përfshihet në agjendën e mbledhjes pasuese. Votimi bëhet **në mënyrë elektronike, nëpërmjet adresës së emailit**, brenda periudhës prej të paktën 7 ditësh ose maksimumi 14 ditësh. Rezultati i votimit bëhet i ditur në mbledhjen e radhës.

Neni 10: Nënkomitetet

- 10.1 Bordi i Akreditimit mund të vendosë për ngritjen e një **komiteti të përhershëm ose të**

përkohshëm, duke përcaktuar detyrat e tij. Nënkomiteti mund të ftojë ekspertë të jashtëm. Ekspertët e jashtëm kanë gjithashtu detyrimin e konfidencialitetit.

10.2 Nënkomiteti zgjedh një **kryetar** midis anëtarëve të tij. Kryetari i nënkomitetit i raporton rregullisht Bordit të Akreditimit për veprimtaritë e nënkomitetit.

10.3 Bordi i Akreditimit vendos për **rregullat procedurale që ndjek nënkomiteti**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 224, datë 15.12.2023

PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES SË BORDIT TË AKREDITIMIT”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Draf Ufga jby Uft XY tf ja jbg Ybwf bt jbg h VcbYh Y Ufga jht Uft bt FYdi V t b Y Ge]d f]g”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Draf i b_gcbja jby Cf[Ubj Y ? cY[UY h 5Xa jbg fUtg G M fcfY XY 9bY Y Di V] Y žLigjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “? cX]] dfcW fU YUXa jbg fUj Y h FYdi V t g g] Ge]d f]g” žVendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Draf cf[U] rja jby XY Z b_gcbja jby 5[Ybwf g] G[i f]a jht 7] t g] bt 5fga jby @Uft Y h 6cfX h t 5_fX] ha jhXY d f d f W_ ha jby h f] Z j Y d f d f c W_ h Y g[i f]a jht W t g] bt Ufga jby Uft I , i ndryshuar, pas shqyrtimit të draft-rregullores së Bordit të Akreditimit në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren e Bordit të Akreditimit”, sipas Shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja e miratuar me vendimin e Bordit të Akreditimit Ekstra nr. 1, datë 02.02.2018, “Draf a jfU ha jby Y f f] i c f Y g] 6cfX h t 5_fX] ha jh” shfuqizohet.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të ASCAL.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.